



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, në datën 18 nëntor 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Të shprehet kundër projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. (**Vendimi nr. 169, datë 18.11.2019**)
2. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “RTV Adriamed” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv “TV Adria Med” sh.p.k. dhe ndryshimin e emrit të shërbimit të programit audiovizive nga “TV Adria Med“ në “Premium Channel”. (**Vendimi nr. 170, datë 18.11.2019**)
3. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “3DS &AF Entertainment” sh.p.k., për ndryshimin e emrit të shërbimit të shërbimit të programit audioviziv nga “TNT” në “Syri Tv”. (**Vendimi nr. 171, datë 18.11.2019**)
4. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Focus Media Neës” sh.p.k., për ndryshimin e emrit të shërbimit të programit audio privat nga radio “RASH” në “Neës 24”. (**Vendimi nr. 172, datë 18.11.2019**)
5. Zëvendësimin e licencës së shoqërisë “Channel Onë” sh.p.k., me licencë për shërbimin e programit audioviziv për qarqet Tiranë, Durrës dhe Fier”. (**Vendimi nr. 173, datë 18.11.2019**)
6. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Pashk Laska, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Laçi”. (**Vendimi nr. 174, datë 18.11.2019**)
7. Rrëzimin e aplikimit të subjektit person fizik Erion Sefaj, për marrje autorizimi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “3ENET”. (**Vendimi nr. 175, datë 18.11.2019**)
8. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Sevi Mediu, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Anfab”. (**Vendimi nr. 176, datë 18.11.2019**)
9. **Pranimin** e ankimit administrativ të subjektit person fizik z. Edi Tanushi dhe shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 15.10.2019, të grupit të inspektorëve, për dënimin me gjobë në masën 1,000,000 lekë”. (**Vendimi nr. 177, datë 18.11.2019**)

10. **Refuzimin** e ankimit administrativ të shoqërisë “Beqaj Kabllor 2014” sh.p.k., autorizuar për subjektin “Tv me kabëll Beqaj” dhe lënien të fuqi të vendimit nr. 19, datë 15.10.2019, të vendosur nga grupi i inspektorëve në masën 1,000,000 lekë. (**Vendimi nr. 178, datë 18.11.2019**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE